



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KANDIDATI PËR “KUSHTETUESE” DREJT KONFIRMIMIT REXHEP BEKTESHI, GJYQ TAR NË GJYKATËN E DURRËSIT, VLERËSIM POZITIV NË TË TREJA KRITERET

Rexhep Bekteshi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë Durrës, me një karrierë 40-vjecare në sistemin e drejtësisë, është drejt konfirmimit në detyrë. Bekteshi, njëherësh kandidat për në Gjykatën Kushtetuese rezultoi pa probleme në të treja kriteret e rivlerësimit, gjatë seancës dëgjimore në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, që zgjati afro 45 minuta.

Sa i përket pasurisë, në raportin e hartuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, rezultonte se subjekti kishte kryer deklarim të saktë, kishte burime financiare të ligjshme, nuk kishte fshehur pasurinë dhe nuk gjendej në kushtet e konfliktit të interesit.

Megjithatë KPK kreu një hetim të thelluar lidhur me pasurinë. Relatorja Firdes Shuli nënvizoi se komisioni i ka gjetur të rregullta të gjitha deklaratimet e kryera nga gjyqtari Bekteshi. Bëhet fjalë për një apartament me sipërfaqe 70.6 m² në Durrës, i privatizuar në vitin 1993 në vlerën e 12,960 lekëve, me burim të ardhurash pagat e subjektit dhe të bashkëshortes. Në përputhje me deklaratimet e gjyqtarit ka rezultuar edhe një shtesë në këtë apartament, e ndërtuar në 1995, me vlerë 450 mijë lekë. Pjesë e hetimit të KPK-së kanë qenë edhe pagesat e energjisë dhe të ujit ndër vite, si edhe një llogari rrjedhëse dhe një depozitë bankare, në emër të gjyqtarit, përkatësisht në shumën e 675 mijë lekëve dhe 505 mijë lekëve. Edhe për llogaritë ka rezultuar se ato janë me burime të ligjshme.

Komisioni nuk ka gjetur probleme edhe tek pasuritë e bashkëshortes dhe djalit të subjektit. Për dy llogari rrjedhëse të bashkëshortes, si edhe një mjet të blerë nga djali i gjyqtarit, me të ardhura nga pagat e prindërve, në vitin 2009, komisioni ka konkluduar se përputhen me deklaratimet e kryera. Sa i përket vajzës së subjektit, relatorja theksoi se e ka plotësuar deklaratën edhe pse nuk e ka pasur detyrim dhe se gjithçka ka rezultuar konform ligjit.

Lidhur me pastërtinë e figurës, DSIK e ka konsideruar subjektin të përshtatshëm për të vazhduar detyrën. Edhe për aspektin profesional, gjyqtari ka marrë një vlerësim pozitiv. Megjithatë dy nga gjashtë denoncimet, sipas relatores I përmbushnin kriteret për t'u marrë në shqyrtim.

Denoncuesit pretendonin për tejkalim të afateve të shqyrtimit dhe mos njoftim në kohë për aktet. Për këtë rast, gjyqtari ka kundërshtuar, duke paraqitur edhe dokumente, u shpreh relatorja.

Bekteshi ka paraqitur fillimisht dokumentet që vërtetonin përfitimin e bursës së vajzës për studime në Greqi, në vitin 2005. Pas një përmbledhje të karrierës së tij në drejtësi, ka kërkuar konfirmimin në detyrë.

Trupi gjykues përbëhej nga Roland Ilia kryesues, Firdes Shuli relatore si edhe Brunilda Bekteshi anëtare, e cila sqaroi se ndonëse mbante të njëjtin mbiemër me subjektin, nuk gjendej në kushtet e konfliktit të interesit. Seanca e rivlerësimit për subjektin Bekteshi, zgjati afro 45 minuta. Realizimi i saj rezultoi në përmbushje të kushteve për një proces të rregullt ligjor. Subjekti i rivlerësimit është njoftuar nga KPK për përfundimin e hetimit, i është vënë në dispozicion e gjithë dosja me dokumentet përkatëse. Si dhe i është kaluar barra e provës. Sjellja e trupit gjykues, ka rezultuar konform me rregullat e etikës. Nga vëzhguesja ndërkombëtare Mia Roessingh nuk ka pasur pyetje apo komente. Vendimi ndaj Bekteshit, do të shpallet me 26 prill.

Këto janë të dhëna paraprake të referuara nga vëzhguesit e KShH-së. Raporti përfundimtar me gjetjet e plota për të gjitha seancat e monitoruara do të publikohet së shpejti nga KShH.